# Funksioni 04: ÇËSHTJE EKONOMIKE

## PROGRAMI 04130: MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

## Përmbajtja


HYRJE ........ 2

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 04130 ........ 2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT ........ 6
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT ........ 10
4. TË DHËNA MBI PROGRAMIN ........ 14
5. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026 ........ 17

## HYRJE

## 1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 04130

<table>
<tr><th colspan="3">Vështrim i përgjithshëm</th></tr>
<tr><td colspan="3">Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor.<br><br>Rregullimi i veprimtarive në sheshet dhe tregjet vendore ose mbështetje për infrastrukturen e tregjeve, si dhe rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja.</td></tr>
<tr><td>Kodi i programit</td><td>Emri i Programit</td><td>Përshkrimi i programit</td></tr>
<tr><td>04130</td><td>Mbështetja për zhvillim ekonomik</td><td>• Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;<br>• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve;<br>• Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;<br>• Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;<br>• Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;<br>• Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.<br>• Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj.<br><br>Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin;</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **04130** | Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi | • Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve;<br>• Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë. |
| **04130** | Zhvillimi i turizmit | • Ndertim, mirembajtje, permiresim dhe funksionim i strukturave perkatese me qellim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor per njesine vendore;<br>• Hartim dhe monitorim i projekteve qe kane per qellim zhvillimin e qendrueshem te njesise se veteqeverisjes vendore.<br>• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor.<br>• Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese e të një natyre të ngjashme;<br>• Përmirësim i hapësirave pamore urbane të Bashkisë, përmesmirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore. |

Rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i ndwrmarrjeve tw Vogla dhe tw mesme. Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kuadër, politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër janë fokusuar në zhvillimin e një ekonomie të gjallë për qytetin dhe zonat rurale sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa nisma në drejtim të:

- Përmirësimit të kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit.
- Thjeshtimit dhe reduktimit të proçedurave administrative.

- Forcimit të bashkëpunimit institucional me qëllim promovimin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Vlen të përmenden disa nisma në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Gjithashtu kujdes i veçantë është treguar për integrimin e brezave të rinj në ekonomi dhe krijimin e mundësive për iniciativa të ndryshme.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike dhe ka një ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

Qëllimi kryesor i aktivitetit të programit është promovimi i zhvillimi të turizmit nëpërmjet zbatimit të politikave favorizuese të këtij sektori. Programi zbatohet nga Bashkia e Shkodrës, aktiviteti i së cilës përqëndrohet në dy drejtime primare, që janë:

- zhvillimi i produktit turistik
- shërbimi ndaj vizitorit.

Bashkia Shkodër, përmes promovimit aktiv të politikave, synon që industria e turizmit të kthehet në burimin kryesor të rritjes ekonomike dhe në një mjet për integrimin e territoreve më pak të zhvilluara dhe përmirësimin e ruajtjen e zonave të trashëgimisë.

## Tabela 1. Shpenzimet e Programitsipas Kategoriveekonomike

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PBA | 2024-2026 | |
| **Raport** | **Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike** | | | | | | |
| **Bashkia Shkoder** | **Institucioni-** | | | | | | |
| **Programi** | 4130 | **Mbështetja për zhvillimin ekonomik** | | | | | |
| Burim financimi : Transferte e pakushtezuar , Transferte sektoriale , Ardhurat e veta dhe Donator | | | | | | | |
| | | | | **Shpenzimet e Programit (000 ALL)** | | | |
| **Emri i Artikullit** | **Kodi i Artikullit** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Fakt** | **Fakt** | **Buxh. Fillest I miratuar VKB 71 dt 27.12.2022** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| **Paga dhe Sigurime** | | | | | | | |
| Paga | **600** | 0 | 0 | 0 | 14,685 | 14,685 | 14,685 |
| Sigurime Shoqërore & Shëndetësore | **601** | 0 | 0 | 0 | 2,336 | 2,336 | 2,336 |
| **Korente** | | | | | | | |
| Mallra dhe Shërbime | **602** | 1,416 | 2,235 | 5,400 | 4,500 | 6,000 | 6,800 |
| Subvencion | **603** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transferta të Brendshme | **604** | 6,089 | 4,350 | 12,800 | 4,000 | 4,000 | 4,000 |
| Transferta të Jashtme | **605** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Transferta për Familje & Individë | **606** | 0 | 0 | 0 | 4,600 | 5,000 | 5,000 |
| **Shpenzime Kapitale** | | | | | | | |
| Aktive të Paprekshme | **230** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Aktive të Prekshme | **231** | 951 | 168 | 0 | 300 | 500 | 500 |
| | | | | | | | |
| **TOTALI** | | **8,456** | **6,753** | **18,200** | **30,421** | **32,521** | **33,321** |

| **Komente** |
|---|
| **Programi 04130: Mbeshtetje per zhillimin ekonomik,** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat.<br><br>Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korrente me:<br>• 56 % në vitin 2024,<br>• 52.3 % në vitin 2025 ,<br>• 51.1 % në vitin 2026.<br><br>Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë:<br>• 43% në vitin 2024,<br>• 46.2 % në vitin 2025,<br>• 47.4 % në vitin 2026.<br><br>Shpenzimet kapitale zënë 1 % të shpenzimeve në vitin 2024 dhe 1.5 % të shpenzimeve në vitet 2025 dhe 2026. |

# 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

**Tabela2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit**

**POLITIKA E PROGRAMIT**

| | |
|---|---|
| **Programi Buxhetor Afatmesëm** | **2024-2026** |

| | | |
|---|---|---|
| **Programi** | **04130** | **Mbështetja për zhvillim ekonomik** |

**Përshkrimi i Programit**

• Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe licensimit të bizneseve;
• Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;
• Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;
• Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;
• Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.
• Publikimi i broshurave informative, krijimi portaleve me profil ekonomik etj. • Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin;
• Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve;
• Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë. •Ndërtim, mirëmbajtje, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatese me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore;
• Hartim dhe monitorim i projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshem të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
• Administrimi i çështjeve dhe shërbirneve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor.
• Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshire prodhimin dhe shpërndarjen e literatures promovuese e të një natyre të ngjashme;
• Përmirësirn i hapësirave pamore urbane të bashkisë, përmes rnirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve zhvillimore duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integrimit Europian. | | | |
| | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Ulët | 47% | 42% | 42% | 42% |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mesme | 38% | 40% | 40% | 40% |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mirë | 15% | 18% | 18% | 18% |
| | Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare- ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | -73% | 0% | 0% | 0% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre në bashkëpunim me institucionet e specializuara dhe aktorët e interesuar. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Ulët | 47% | 42% | 42% | 42% |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mesme | 38% | 40% | 40% | 40% |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjise territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ; E Mirë | 15% | 18% | 18% | 18% |
| 1.2. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Programimi dhe zbatimi efiçient i financimeve të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë si dhe forcimi i marredhënieve me diasporën. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare- ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | -73% | 0% | 0% | 0% |
| | Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe Organizata të tjera ndërkombëtare ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 0% | 0% | 0% | 0% |
| | Numri i aktiviteteve me karakter informues - Ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 0% | 0% | 0% | 0% |
| | Numri i personave të informuar -Ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 0% | 88% | 67% | 0% |
| 1.3. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Përmirësimi i Klimës së Biznesit përmes panaireve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse, publikimit të materialeve promocionale si dhe iniciativave financiare në mbështetje të biznesit të vogël. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Bizneseve të mbështetura në skemë financiare - Raporti në % i kundrejt vitit të kaluar | -40% | 0% | 0% | 0% |
| | Rritja e kapaciteteve të sipërmarrësve të rinj në sektorin AGRO | 0% | 20% | 0% | 0% |
| | Bizneseve të asistuara per aplikime në skema financiare -Raporti në % i kundrejt vitit të kaluar | 0% | 0% | 0% | 0% |
| 2 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë. | | | |
| | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Numri i tregjeve funksionale në bashki në përputhje me kriteret e lejes përkatëse | 4 | 4 | 4 | 4 |
| | Përqindja e njësive të tregjeve publike funksionale të mirëmbajtura në raport me totalin | 52% | 52% | 52% | 52^% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Numri i tregjeve funksionale në bashki në përputhje me kriteret e lejes përkatëse | 4 | 4 | 4 | 4 |
| | Përqindja e njësive të tregjeve publike funksionale të mirëmbajtura në raport me totalin | 52% | 52% | 52% | 52% |
| | Përmirësimi i infrastrukturës së tregjeve vendore nëpërmjet investimeve - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 0% | 0% | 0% | 0% |
| 3 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Nxitja e zhvillimit të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit te Bashkisë Shkodër, si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor dhe ekonomik. | | | |
| | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit - Materiale promovuese dhe informuese turistike të prodhuara – ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 3% | 7% | 5% | 0% |
| | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit | 6 | 4 | 4 | 4 |
| 3.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Komunikimi nëpërmjet platformave online dhe materialeve promovuese/ informuese. – ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 7% | 3% | 9% | 0% |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit - Materiale promovuese dhe informuese turistike të prodhuara – ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 3% | 7% | 5% | 0% |
| 3.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet permiresimit te infrastruktures turistike | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Numri I shtigjeve te mirembajtura | | 100% | 50% | 0% |
| 3.2. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | -33% | 50% | 0% | 0% |
| | Pjesëmarrës ne festivalin e kulinarise - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 100% | 22% | 18% | 5% |
| 3.3. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit | 6 | 4 | 4 | 4 |
| **3.4.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Biznese turistike të mbështetura ( ide inovative për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm) | 5 | 1 | 1 | 1 |
| **4** | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Funksionimi i zyrave vendore turistike përmes koordinimit të aktorëve dhe strukturave përgjegjëse në industrinë turistike; Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit. | | | |
| | Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Përmirësimi i shërbimit në sektorin e turizmit. Numri i personave të akomoduar në hotele. Ndryshimi vjetor në numër. | 4,286 | 1,357 | 1,500 | 5,000 |
| | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi : Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar. | 1% | 15% | 0% | 0% |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit - Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 60% | 17% | 0% | 0% |
| **4.1.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për zhvillimin e turizmit. | | | |
| | Treguesit e Performancës për Objektivin | | | | |
| | Përmirësimi i shërbimit në sektorin e turizmit. Numri i personave të akomoduar në hotele. Ndryshimi vjetor në numër. | 4,286 | 1357 | 1500 | 5000 |
| | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi : Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 1% | 15% | 0% | 0% |
| | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi : Të ardhurat nga taksa e hoteleve kundrejt totalit të të ardhurave nga taksat vendore (Raporti në %) | 6% | 6% | 6% | 6% |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit - Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit - ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar | 60% | 17% | 0% | 0% |
| | Përmirësimi i shërbimit të stafit- numri i stafit në total | 16 | 13 | 13 | 13 |

## 3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

### Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

**SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT**

| | |
|---|---|
| **Programi Buxhetor Afatmesëm** | **2024-2026** |

| | | |
|---|---|---|
| **Programi** | **04130** | **Mbështetja për zhvillim ekonomik** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.1.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre në bashkëpunim me institucionet e specializuara dhe aktorët e interesuar. | | | |
| **1.1.A.** | **Produkti** | Plani Strategjik i Zhvillimit | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04130.Q1.O1.A1.-A2 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me hartimin apo rishikimin e planit strategjik të zhvillimit të NJVQV. | | | |
| | Njësia Matëse | Numër projektesh | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 198 | 198 | 198 | 198 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | #DIV/0! | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **1.2.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Programimi dhe zbatimi efiçient i financimeve të programeve të BE-se dhe donatorëve të tjerë si dhe forcimi i marrëdhënieve me diasporën. | | | |
| **1.2.A.** | **Produkti** | Pjesëmarrja në programe dhe projekte ndërkombëtare | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04130.Q1.O2.A1-A3 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare. | | | |
| | Njësia Matëse | Numri i projektesh dhe personash te informuar | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 131 | 131 | 131 | 131 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 1,300 | 1,700 | 1,700 | 1,700 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 9.9 | 13.0 | 13.0 | 13.0 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | 30.8% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | 30.8% | 0.0% | 0.0% |
| **1.3.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Permirësimi i Klimës së Biznesit përmes panaireve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse, publikimit të materjaleve promocionale si dhe incentivave financiare në mbështetje të biznesit të vogël. | | | |
| **1.3.A.** | **Produkti** | Mbështetje me grante për biznesin e vogël | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04130.Q1.O3.A1-A3 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Ky produkt paraqet buxhetin e caktuar nga NJVQV për skemën e granteve konkuruese që do të akordohen me qëllim zhvillimin e startup-eve, biznesit të vogël, etj. | | | |
| | Njësia Matëse | Numri i bizneseve të mbështetura | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 120 | 120 | 120 | 120 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 3,400 | 4,900 | 4,900 | 4,900 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 28.3 | 40.8 | 40.8 | 40.8 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | 44.1% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | 44.1% | 0.0% | 0.0% |
| **2.1.** | **Objektivi i Politikës së Programit** | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |
| **2.1.A.** | **Produkti** | Subjekte të sistemuara në Tregun e Ushqimeve | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04160.Q2.O1.A1.-A3 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Materiale konsumi, energjia elektrike, shërbimi dhe materiale të tjera mirëmbajtjeje, materiale hidraulike, shpenzime mirembajtje kaldaje, materiale ndricimi, pagesa e ujit, shpenzime pastrimi dhe disifektimi, shpenzime sigurimi, etj. për tregun ushqimor. | | | |
| | Njësia Matëse | Numri i vendeve të shitjes | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 120 | 120 | 120 | 120 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 1,000 | 0 | 0 | 0 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 8.3 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.0% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | -100.0% | #DIV/0! | #DIV/0! |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | -100.0% | #DIV/0! | #DIV/0! |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative.Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.<br>Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet permiresimit te infrastruktures turistike Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare. Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër. | | | |
| 3.1.A. | **Produkti** | Promovimi i Turizmit | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04130.Q3.O1.A1 - P04130.Q3.O5.A1 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Promovimi i turizmit realizohet, por nuk kufizohet në shërbimet e Zyrës së Info Point, promovimi i destinacioneve të ndryshme turistike; hartimi dhe shpërndarja e hartave turistike, udhërrëfyesve, etj.; realizimi i aktiviteteve të ndryshme promovuese si Dita Botërore e Edukimit; dita botërore e turizmit; etj. | | | |
| | Njësia Matëse | Numri i materialeve promocionale | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 7,000 | 7,500 | 7,900 | 7,900 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 8,800 | 6,500 | 8,400 | 9,200 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 1.3 | 0.9 | 1.1 | 1.2 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | 7.1% | 5.3% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | -26.1% | 29.2% | 9.5% |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | -31.1% | 22.7% | 9.5% |
| 4.1. | **Objektivi i Politikës së Programit** | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për zhvillimin e turizmit. | | | |
| 4.1.A. | **Produkti** | Shërbimi i Stafit të zhvillimit të Turizmit | | | |
| | ***Kodi i Projektit*** | P04130.Q4.O1.A2 | | | |
| | Përshkrimi i Produktit: | Ofrimi i shërbimit turistik dhe pagesa e pagave e sigurimeve për stafin e turizmit dhe mbështetjen operative. | | | |
| | Njësia Matëse | Numri i stafit | | | |
| | | **2023** | **2024** | **2025** | **2026** |
| | | **Buxheti** | **Plani** | **Plani** | **Plani** |
| | Sasia | 16 | 13 | 13 | 13 |
| | Kosto totale (në mijë lekë) | 7,557 | 17,321 | 17,521 | 17,521 |
| | Kosto për njësi (në mijë lekë) | 472.3 | 1,332.4 | 1,347.8 | 1,347.8 |
| | Ndryshimi në % i Sasisë | | -18.8% | 0.0% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos totale | | 129.2% | 1.2% | 0.0% |
| | Ndryshimi në % i kostos për njësi | | 182.1% | 1.2% | 0.0% |

# Projektet e Investimeve të Programit

2024-2026

| Projektet e Investimeve | | |
|---|---|---|
| Bashkia Shkoder | Institucioni - | |
| Burim financimi | Transferte e pakushtezuar , Transferte sektoriale , Ardhurat e veta dhe Donator | |
| Programi | 4130 | Mbështetja për zhvillimin ekonomik |

| Kodi Projektit | Emri i Projektit | Kosto Totale e Projektit | Burimi i Financimit | Data Fillimit | Data Përfund. | 2021 | 2022 | Buxh. Fillest I miratuar VKB 71 dt 27.12.2022 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Fakti | Fakti | Buxheti | Plani | Plani | Plani |
| 1410468 | Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese | 558 | Fondet e veta | 2021 | 2021 | 558 | | | | | |
| | Rikonstruksion I Zyrave te informacionit | | | | | | | | 300 | 500 | 500 |
| 1410842 | Rikonstruksion i zyrave te Informacionit turistik,Qyteti i Shkoder,Velipoje,Theth | 588 | Fondet e veta | 2021 | 2022 | 393 | 168 | | | | |
| | **Totali** | **1,146** | | | | **951** | **168** | **0** | **300** | **500** | **500** |

# 4. Të Dhëna mbi Programin

**Tabela4 Të dhënat e Programit**

**Të Dhëna Bazë mbi Programin**

| Programi 4130 | Të Përgjithshme | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| **Të dhënat e programit/ Vitet** | | | | | | | | | |
| Numri i projekteve gjithsej te Dokumenti i Strategjisë territoriale të zhvillimit të Bashkisë Shkodër | | 198 | 198 | 198 | 198 | 198 | 198 | 198 | 198 |
| Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të ulët zbatimi | | 129 | 123 | 113 | 103 | 93 | 83 | 83 | 83 |
| Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të mesëm zbatimi | | 55 | 60 | 65 | 70 | 75 | 80 | 80 | 80 |
| Numri i projekteve të realizuara në PBA me ecuri të mirë zbatimi | | 14 | 15 | 20 | 25 | 30 | 35 | 35 | 35 |
| Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare Reload | | 12 | 9 | 4 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 |
| Numri i projekteve të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | | 5 | 6 | 24 | 13 | 13 | 13 | 13 | 13 |
| Numri i projekteve të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | | 16 | 16 | 7 | 22 | 6 | 6 | 6 | 6 |
| Numri i aktiviteteve informuese të organizuara | | 30 | 42 | 42 | 45 | 45 | 45 | 45 | 45 |
| Numri i personave të informuar | | 170 | 200 | 220 | 240 | 240 | 240 | 240 | 240 |
| Numri i materialeve informative të publikuara/botuara për zhvillimin ekonomik. | | 0 | 1 | 0 | 1 | | | | |
| Numri i bizneseve të mbështetura për zhvillim | | 200 | 190 | 201 | 200 | 120 | 120 | 120 | 120 |
| Numri i bizneseve të asistuara në aplikime në programe dhe skema financiare | | 24 | 30 | 30 | 25 | 25 | 25 | 25 | 25 |
| Numri i personave të informuar ne lidhje me diasporen dhe migracionin | | | | | | 80 | 150 | 250 | 250 |
| Numri sipermarrësve të rinj të mbështetur në sektorin AGRO | | | | | | 25 | 30 | 30 | 30 |
| Numri total i vendeve të shitjes në tregje publike | | 230 | 230 | 230 | 230 | 230 | 230 | 230 | 230 |
| Numri i vendeve të shitjes në tregje publike të mirëmbajtura (pagesë e shërbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | | 120 | 120 | 120 | 120 | 120 | 120 | 120 | 120 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i tregjeve funksionale publike me kriteret e lejes përkatëse | | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 |
| Popullsia totale e bashkisë | | 208,618 | 209,542 | 210,182 | 211,137 | 212,467 | 212,467 | 212,467 | 212,467 |
| Investimet bashkiake për ndërtimin tregjeve në mijë lekë | | 543 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Numri i platformave promovuese | | 2 | 2 | 0 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Numri i vizitorëve në faqen e turizmit të Bashkisë. | | 35,000 | 35,000 | 6,900 | 67,000 | 69,000 | 70,000 | 75,000 | 75,000 |
| Numri i shkarkimeve të aplikacionit | | 8,000 | 2,150 | 2,750 | 35,000 | 40,000 | 42,000 | 47,000 | 47,000 |
| Numri I shtigjeve te mirembajtura | | | | | | | 2 | 3 | 3 |
| Numri i materialeve promocionale të prodhuara. (harta, guida etj) | | 10,070 | 7,100 | 5,000 | 6,800 | 7,000 | 7,500 | 7,900 | 7,900 |
| Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare | | 1 | 1 | 0 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 |
| Nr i sipermarrjeve te promovuara | | | | | | 45 | 55 | 65 | 68 |
| Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit | | | | | | 6 | 4 | 4 | 4 |
| Numri i iniciativave të bizneseve turistike të mbështetura | | 0 | 0 | 0 | 20 | 5 | 1 | 1 | 1 |
| Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele | | 282,229 | 105,425 | 185,243 | 292,857 | 297,143 | 298,500 | 300,000 | 305,000 |
| Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel në 000/Lekë - | | 19,756 | 7,380 | 12,967 | 20,500 | 20,800 | 24,000 | 24,000 | 24,000 |
| Të ardhura nga taksa e taksat vendore në 000/Lekë e realizuar | | 268,810 | 233,917 | 259,082 | 346,037 | 364,326 | 376,487 | 406,529 | 411,337 |
| Numri i turistëve që marrin informacion nga zyra | | 10,500 | 2,500 | 7,200 | 7,500 | 12,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 |
| Numri i zyrave të informacionit turistik | | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Numri I punonjeseve / stafi I Drejtorise se Turizmit dhe Drejtoria e planifikimit strategjik dhe permiresimi i klimes se biznesit | | | | | | 16 | 13 | 13 | 13 |

# 5. Projektet e planifikuara për PBA 2024-2026

### Tabela 5 Emërtimet e aktiviteteve

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Totali | | |
| | | | 2024 | 2025 | 2026 |
| | | | Totali | Totali | Totali |
| Plani Strategjik I zhvillimit ( procesi i monitorimit dhe rishikimit te stategjise territoriale te zhvillimit te Bashkise Shkoder) | P04130.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | Bashkia Shkoder | - | - | - |
| Pjesmarrja ne programe dhe projekte nderkombetare | P04130.Q1.O2.A1.Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj | Bashkia Shkodër | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P04130.Q1.O2.A2. Bashkia për BE-në | Bashkia Shkodër | 300 | 300 | 300 |
| | P04130.Q1.O2.A3.Diaspora dhe migracioni | Bashkia Shkodër | 400 | 400 | 400 |
| Promovimi I biznesit dhe zhvillimit ekonomik | P04130.Q1.O3.A1. Rrjeti europian per sipermarrjen rinore | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q1.O3.A2. Krijimi I nje platforme per promovimin e biznesit lokal. | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| Mbeshtetje me grante per biznesin e vogel | P04130.Q1.O3.A3. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit ne Shkoder | Bashkia Shkodër | 1,600 | 1,600 | 1,600 |
| | P04130.Q1.O3.A4. Mbështetje per bizneset Agro | Bashkia Shkodër | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P04130.Q1.O3.A5.Skeme Granti | Bashkia Shkodër | 2,300 | 2,300 | 2,300 |
| | **TOTALI QELLIMI 1** | | **6,600** | **6,600** | **6,600** |
| Subjekte te sistemuara ne tregun e ushqimeve | P04130.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A2.Koordimini me SH.A. e menaxhimit te tregjeve publike | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A3. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A4. Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | **TOTALI QELLIMI 2** | | **-** | **-** | **-** |
| Promovimi I Turizmit | P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për web sitin e turizmit. | Bashkia Shkodër | - | - | 150 |
| | P04130.Q3.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit | Bashkia Shkodër | - | - | 150 |
| | P04130.Q3.O1.A3. Prodhim, publikim dhe botim I materialeve promocionale | Bashkia Shkodër | 500 | 2,000 | 2,500 |
| | P04130.Q3.O2.A6 Përmirësimi I aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve | Bashkia Shkodër | 600 | 600 | 600 |
| | P04130.Q3.O3.A1.Shkodra në tour | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q3.O3.A2. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën | Bashkia Shkodër | 800 | 800 | 800 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | turistike të Shkodrës | | | | |
| | P04130.Q3.O3.A3. Itenerarët e shijes/promovimi i Slow food | Bashkia Shkodër | 1,200 | 1,500 | 1,500 |
| | P04130.Q3.O4.A1. Festa e Liqenit | Bashkia Shkodër | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P04130.Q3.O4.A2. Hapja e sezonit turistik Velipoje | Bashkia Shkodër | - | - | - |
| | P04130.Q3.O4.A3. Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë së zonave malore | Bashkia Shkodër | 900 | 1,000 | 1,000 |
| | P04130.Q3.O4.A4. Dita e biçikletave | Bashkia Shkodër | 500 | 500 | 500 |
| | P04130.Q3.O4.A6. Lojra Popullore Fest | Bashkia Shkodër | 500 | 500 | 500 |
| | P04130.Q3.O5.A1.Mbështetja e iniciativave të reja në mbështetje të zhvillimit të turizmit | Bashkia Shkodër | 500 | 500 | 500 |
| Sherbimi I stafit te zhvillimit te turizmit | P04130.Q4.O1.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth | Bashkia Shkodër | 300 | 500 | 500 |
| | P04130.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të mbeshtetjes per zhvillim ekonomik dhe turizem | Bashkia Shkodër | 17,021 | 17,021 | 17,021 |
| | **TOTALI QELLIMI 3+4** | | **23,821** | **25,921** | **26,721** |
| | **PROGRAMI 4130 - MBESHTETJA PEER ZHVILLIM EKONOMIK** | | **30,421** | **32,521** | **33,321** |

| Nr. 1 | **P04130.Q1.O1.A1.** Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me ‘monitorimin dhe vlerësimin’ e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.

**ii. Synimi i projektit**

Projekti ka për qëllim të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i planit për analizën e të dhënave;
2. Analizimi i të dhënave për ndikimin e planit, zbatimi i aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve të tij;
3. Gjetja e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
4. Përgatitja e raportit të monitorimit dhe vlerësimit;
5. Shpërndarja e informacionit.

**b) Rezultatet që prisni**

- Realizimi i monitorimit për çdo vit në fund të një viti fiskal i Planit të Përgjithshëm Vendor për situatën aktuale dhe zbatimin e PPV-së për identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjes dhe matjen e progresit ndaj rezultateve të dhëna.
- Realizimi i vlerësimit të kryer në mes dhe në fund të përiudhës së zbatimit të i Planit të Përgjithshëm Vendor.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Grupet e interesit | Bashkia Shkodër, Donatorë, Programe të BE-së. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Monitorimi dhe vleresimi i Planit | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) ) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr. 2 | **P04130.Q1.O1.A2.** Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**N/Funksioni 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130:** Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër ka përmbushur me sukses detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga angazhimi i saj në Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër mori përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projektit ReLOaD dhe angazhimin e organizimit të tre thirrje publike (periudhën kohore 2018 – 2020), nga të cilat, dy të parat u financuan nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit u financua nga fondet e vetë bashkisë. Të gjitha Thirrjet për projekt propozime u realizohen në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”. Aktualisht Bashkia Shkodër ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me UNDP Albania në kuadër të RELOAD 2, e cila do të përfundojë në 31 dhjetor të vitit 2024. Ky memorandum prevalon dhe zëvëndëson në tërësinë e tij memorandumin e bashkëpunimit të nënshkuar nga Bashkia Shkodër në vitin 2017 dhe ka për qellim:

1. Shkëmbimin e eksperiencave midis bashkive partnere të ReLOaD nëpërmjet bashkëpunimit me programin në Shqipëri dhe Bashkinë Shkodër (si mentor).
2. Shkëmbimin direkt të njohurive midis qeverisjes vendore pjesëmarrëse, OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë në nivel rajonal.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi është zbatimi i qasjes në bazë projekti, në mënyrë që bashkitë të realizojnë objektivat e tyre zhvillimore, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Bashkia Shkodër angazhohet të organizojë thirrjet publike për organizatat e shoqërisë civile në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perendimor (Reload), sipas metodologjisë LOD miratuar me VKB nr. 69, datë 30.10.2017:
2. Përcaktimi i prioriteteve
3. Lancimi i thirrjes
4. Vlerësimi i projekteve
5. Zbatimi dhe Monitorimi i projekteve fituese.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane;
- Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje;
- Rritje e transparencës me publikun

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>UNDP Albania<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)<br>Bashkia Shkodër<br>Programet e BE |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) ) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>**Institucioni likujdues**: Bashkia Shkodër |
|---|---|

<table>
<tr><td>Nr. 3</td><td>P04130.Q1.O2.A1.Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj</td><td>Funksioni 4: Çështje ekonomike<br>NN/Funksion 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="3">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="3">Procesi i integrimit evropian është një proces shumë i rëndësishëm për të gjitha bashkitë në vend, i cili do të sjellë më pranë qytetarët shqiptarë dhe administratën vendore me BE-në, politikat dhe programet e saj. Ky proces përkthehet në negocimin e 33 kapitujve të Acquis së BE dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Pothuajse 50-70% e kuadrit ligjor të BE-së duhet të zbatohet në nivel vendor prandaj acquis-i i BE-së ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.<br><br>Duke e konsideruar integrimin në BE si perspektiven më të mirë të zhvillimit dhe si një sfidë e përbashkët e vendeve të rajonit, Bashkia Shkodër ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa qytete në rajon, me lidhje të hershme ndër shekuj dhe me vlera që na bashkojnë në fushën ekonomike, kulturore e njerëzore. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësisë së veçantë jo vetëm për gjenerimin e ideve për të intensifikuar bashkëpunimin rajonal por edhe në terheqjen e fondeve të Bashkimit Europian, në kuadër të programeve të ndryshme ndërkufitare. Një rajon i cili zhvillon projekte të përbashkëta në funksion të një zhvillimi ekonomik të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, u shërben jo vetëm interesave vendore por përbën gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në procesin e integrimit europian.<br><br>Pjesë e kësaj fishe do të jetë edhe mbulimi i shpenzimeve për projektet e shpallura fituese në kuadër të programeve kombëtare.<br><br>Gjithashtu Bashkia Shkodër do të intensifikojë përpjekjet e saj në drejtim të anëtarësimit në shoqata ndërkombëtare me qellim zhvillimin ekonomik të vendit, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe mbrojtjen e mjedisit në bashkëpunim me vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm. Natyrisht anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare sjell të drejta dhe detyrime për vendet anëtarë, brenda kufijve të përcaktuara në statut. Një ndër këto detyrime është edhe shlyerja e kuotës vjetore të anëtarësisë. Prandaj për çdo anëtarësim të mundshëm në shoqata ndërkombëtare, Bashkia Shkodër merr përsipër përmbushjen e detyrimeve financiare (shlyerjen e kuotës vjetore të anëtarësisë) për kohën gjatë së cilës është pjesë e shoqatës.<br><br>Sa mësipër, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së. Gjatë viteve të fundit numri i projekteve të financuara në kuadër të thirrjeve të IPA dhe programe të tjera të financuara nga BE është i konsiderueshëm. Përmendim këtu Programi Adrion Interreg, Horizon Europe, Europe Aid Call for Proposal, IPA Crossborder Shqipëri – Mali i Zi, Programi MED, etj.<br><br>Në të dyja rastet lind e nevojshme parashikimi i një fondi për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Të parashikojë fondin për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe të parashikojë fondin për mbulimin e shpenzimeve në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Europian për përiudhën 2024 – 2026.</td></tr>
<tr><td colspan="3">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">1. Bashkia Shkodër do të përmbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare.<br>2. Bashkia Shkodër do të përmbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga marrëveshjet e granteve të nënshkuara nga Bashkia Shkodër në përputhje me legjislacionin në fuqi.</td></tr>
<tr><td colspan="3">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="3">– Ngritje e kapaciteteve institucionale;<br>– Rritja e numrit të projekteve të financuara nga programe te ndryshme;<br>– Përfshirje e Bashkisë Shkodër në shoqata ndëkombëtare;<br>– Rritje e transparencës me publikun.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td><td>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian</td><td>Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së<br>Shoqata ndërkombëtare<br>Donator të tjerë</td></tr>
<tr><td colspan="3">e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)</td></tr>
</table>

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2024 | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigu rime | Oper ative | Trans ferime | Kap itale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 400 | | | | 400 | |
| A.2 | Vlera e mbulimit të shpenzimeve të programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të ndihmës së huaj/kombëtare | 600 | | | 600 | | |
| | Shuma | **1,000** | | | **600** | **400** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigu rime | Oper ative | Trans ferime | Kap itale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 400 | | | | 400 | |
| A.2 | Vlera e mbulimit të shpenzimeve të programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të ndihmës së huaj/kombëtare | 600 | | | 600 | | |
| | Shuma | **1,000** | | | **600** | **400** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigu rime | Oper ative | Trans ferime | Kap itale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 400 | | | | 400 | |
| A.2 | Vlera e mbulimit të shpenzimeve të programuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projekte të ndihmës së huaj/kombëtare | 600 | | | 600 | | |
| | Shuma | **1,000** | | | **600** | **400** | |
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër | | | | |

| Nr. 4 | P04130.Q1.O2.A2. Bashkia për BE-në | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore", janë krijuar strukturat e Integrimit Evropian në 61 Bashkitë e Shqipërisë. Në këtë kuadër është krijuar struktura edhe në Bashkinë Shkodër, misioni i secilës është të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga proçesi i Integrimit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efiçencë të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.

Sa më sipër ky sektor do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor duke organizuar aktivitete të ndryshme informuese dhe promovuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian. Për këtë qellim çdo muaj sektori i integrimit evropian Shkodër organizon minimalisht 2 aktivitete në muaj sipas tematikave të caktuara dhe sipas ditëve evropiane dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale, Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi, etj. Numri i pjesmarrësve në këto aktivitete varion nga 20 pjesmarrës, në rastin e takimeve me fokus grupet deri në 400 pjesmarrës në rastin e aktiviteteve të mëdha promovuese.

**ii. Synimi i projektit**

1. Të promovojë parimet e Bashkimit Evropian në nivel vendor;
2. Të krijojë një ndërveprim efektiv midis BE-së, qeverisjes qendrore dhe zyrës së çështjeve të BE -së në secilën Bashki në Shqipëri.
3. Të rrisë njohuritë për IPA-n si dhe fondet e tjera kryesore të BE-së të disponueshme për bashkitë dhe qytetarët Shqiptarë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Bashkia Shkodër do të organizojë aktivitete promovuese dhe informuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet zyrës së çështjeve të BE-së Shkodër.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Përmirësim i shërbimeve me standarde evropiane;
- Rritje e transparencës me publikun;
- Njohja e politikave dhe programeve të BE-së.

| c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.) |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së<br>Donator të tjerë |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **300** | | | **300** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **300** | | | **300** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **300** | | | **300** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 5** | **P04130.Q1.O2.A3**. Diaspora dhe migracioni | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme |

| | | |
|---|---|---|
| | | ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Me funksionet e shtuara të pushtetit vendor në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës, Bashkisë Shkodër i lind detyrimi dhe përgjegjësia që nga njëra anë të kontribuojë në ri-integrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të emigrantëve duke respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e tyre njerëzore,dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushte të favorshme, të cilat i mundësojnë diasporës, përmes kapaciteteve të tyre intelektuale, njerëzore, ekonomike dhe sociale, të pasurojë shoqërinë tonë, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal.
Në këtë kuadër lind nevoja e informimit të publikut mbi kompetencat, ndihmën dhe mundësitë që Bashkia Shkodër ofron për këto dy kategori: nga njëra anë emigrantet e kthyer, të cilët duan të rikthehen, të jetojnë dhe të kontribuojnë në vendin e tyre dhe nga ana tjetër diaspora, e cila ruan dhe kërkon të çojë përpara lidhjen shpirtërore me vendin e origjinës duke kontribuar në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike të tij.

**ii. Synimi i projektit**

1. Të rrisë njohuritë mbi politikat e Bashkisë Shkodër në lidhje me migracionin dhe diasporën.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Bashkia Shkodër do të sigurojë informimin e publikut dhe veçanërisht grupet e tjera të interesit për politikat e saj në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës.

**b) Rezultatet që prisni**

- Informimi i publikut në lidhje me politikat vendore për çështjet e migracionit dhe diasporës;
- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Rritje e transparencës me publikun.

| c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.) |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian<br>Agjensia për diasporen | Bashkia Shkodër<br>Programet e BE-së<br>Shoqata dhe organizata për migracionin dhe diasporën<br>Organizata ndëtkombëtare. |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigur ime | Oper ative | Transf erime | Kapit ale |
| A. 1 | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 400 | | | 400 | | |
| | **Shuma** | **400** | | | **400** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigur ime | Oper ative | Transf erime | Kapit ale |
| | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 400 | | | 400 | | |
| | **Shuma** | **400** | | | **400** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigur ime | Oper ative | Transf erime | Kapit ale |
| | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 400 | | | 400 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shuma** | **400** | | | **400** | | |
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.6** | **P04130.Q1.O3.A1** Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër. | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin e mbështetjes së përmirësimit të biznesit përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno". Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë, Shoqata e bizneseve ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Ka ofruar konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Në këtë kuadër vazhdimi i bashkëpunimit me shoqatën e bizneseve në shërbim të përmirësimit të zonave të biznesit do të realizohet me anë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqatës egzistuese të bizneseve përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno".
Hapsira publike do të trajtohet me rigorozitet sipas vendimit të Këshillit të rregullimit të Territorit.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi kryesor i bashkëpunimit është që të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe më tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t'iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt si dhe turisteve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të ardhurave, nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr. 13, datë 12.03.2012.

**b) Rezultatet që prisni**

- Forcimi dhe zhvillimi i bizneseve egzistuese, krijimi i bizneseve të reja si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, që ndodhen përgjatë rrugës "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno".

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>AADF<br>BID Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër,<br>nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | 1,600 | | | | 1,600 | |
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | 1,600 | | | | 1,600 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| **A.1** | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | 1,600 | | | | 1,600 | |
| **Shuma** | | **1,600** | | | | **1,600** | |
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr. 7 | **P04130.Q1.O3.A2.** Mbështetje per bizneset Agro | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Territori i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, zona fushore dhe malore e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndismat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale si një nga sektorët që i lidh të gjitha njesitë administrative. Fermerët e njësive administrative tashmë kanë filluar të zhvillojnë edhe sektorin agroturistik, mirëpo është parë e nevojshme të mbështeten nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të sipërmarrësve të rinj mbi mënyrën e përpunimit, tregtimit, promovimit me anën e përfshirjes së tyre në rrjete të reja tregtare.
**"Mbeshtetja e bizneseve Agro"** nepermjet krijimit te rrjetit te fermereve do tu jape mundësinë të mësojnë dhe të praktikojnë atë që sot ata e kanë si "pikë të dobët", si të marketojnë dhe të brandojnë produktet, si të paketojnë, si të magazinojnë produktet në standartin e duhur, etj. Një grup ekspertësh të sigurisë ushqimore, standartizimit, agronomë, njohës të marketingut dhe brandimit të produkteve ushqimore do të japin eksperiencën e tyre në këtë projekt zhvillimi përgjatë gjithë kohëzgjatjes se projektit.
Po kështu promovimi i produkteve vendore të sipermarrjeve të reja dhe atyre egzistuese në njesite administrative do t'i shërbejë rritjes social-ekonomike të gjithë territorit dhe përmirësimin e jetës së komunitetit.

**ii. Synimi i projektit**

Ky projekt synon rritjen e kapaciteteve të fermereve /sipermarrësve të rinj, promovimin e sipermarrjeve rinore Agro si dhe produkteve vendase me qellim zhvillimin e qendrueshem ekonomik të njësive administrative të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Analiza e situatës në territorin e Bashkisë Shkodër;
2. Ndertimi i rrjetit te fermereve te rinj nga njesi te ndryshme administrative;
3. Trajnim mbi sigurinë ushqimore, marketimin dhe brandimin;
4. Sesion informues mbi funksionimin e rrjetëzimit (ndërveprimi), rëndësia e përfshirjes në rrjetin e fermerëve;
5. Hartimi i nje plani veprimi komunikimi që do të shërbejë për promovimin e aktiviteteve.

**b) Rezultatet që prisni**

- Rritja e kapaciteteve te sipërmarrësve të rinjë;
- Numri i nismave rinore të mbështetura në sektorin Agro

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Dhoma e Tregtisë<br>Biznese Prodhuesish<br>Shoqata që operojnë në këtë fushë<br>Banorët e Nj. Administrative | Bashkia Shkodër<br>Donatorë |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transfer ime | Kapitale |
| A.1 | Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro. | 1,000 | | | 1,000 | | |

| | Shuma | 1,000 | | | 1,000 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transfer ime | Kapitale |
| A.1 | Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro. | 1,000 | | | 1,000 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | **1,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transfer ime | Kapitale |
| A.1 | Oranizimi i aktiviteteve per rritjen e kapaciteteve te sipermarresve te rinje dhe Mbështetje e Iniciativave Rinore ne sektorin Agro. | 1,000 | | | 1,000 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | **1,000** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |

| Nr. 8 | **P04130.Q1.O3.A3.** Skeme granti | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Vendi jonë është tashmë pjesë e rrjetit evropian të NMV-ve. Zbatimi i politikave pro aktive për të mbështetur rritjen e kapaciteteve të NMV-ve mbetet një sfidë. Parë në këtë këndvështrim, inkurajimi i iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe ekzistuese është shumë i rëndësishëm për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkuruese dhe inovative. Kur këto iniciativa ndërthurin sëbashku konceptet e ekonomisë, ekologjisë dhe inovacionit, krijojnë një model të ri zhvilimi ekonomik, të aftë për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit pa dëmtuar mjedisin. Një qasje e tillë quhet eko-inovacion dhe është termi më ri botëror. Eko-inovacioni i referohet të gjitha formave të inovacionit teknologjik dhe jo vetëm, produkteve dhe shërbimeve të reja që krijohen me qellim zhvillimin e mundësive të reja të bërit biznes, duke parandaluar ose zvogëluar ndikimet negative në mjedis, ose duke optimizuar shfrytëzimin e burimeve natyrore. Biznesi po njeh gjithnjë e më shumë avantazhet konkurruese për të fituar nga eko-qëndrueshmëria dhe marketingu i gjelbër. Zbatimi i eko-inovacionit është një proces sfidues prandaj është e rëndësishme të fitohen njohuritë e nevojshme në lidhje me dinamikën e ekosistemeve dhe dobësitë e tyre.

Qëllimi jonë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe sherbimeve të NMV-ve një vlerë të shtuar në treg. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të ndërtohen kapacitetet e të rinjve me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të gjelbër. Sot, një fuqi punëtore që ka kuptuar rëndësinë e "gjelbër" të punës përbën avantazh në tregjet e reja pasi kërkesa për produkte jeshile sa vjen dhe rritet. Një proçes i tillë përfshin prodhimin, asimilimin ose shfrytëzimin e një produkti, procesi prodhimi, shërbimi apo menaxhimi tërësisht të ri për biznesin dhe çon në uljen e kostove, reduktimin e rrezikut mjedisor, ndotjes dhe ndikimeve të tjera negative të përdorimit të burimeve krahasuar me alternativat ekzistuese.

Në këtë kuadër Bashkia Shkodër synon të mbështesë dhe nxisë inovacionin për ide biznesi të gjelbërta tek tek të rinjtë që deshirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta, të bazuara në shfrytëzimin e burimeve vendore, duke pasur një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Një skemë granti do të hartohet në bashkëpunim me institucionet financiare dhe institucionet e tjera përgjegjëse në mbështetje të start up-eve, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese. Përfitues do të jenë shtetasit shqiptar të moshës 18- 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër të cilët kanë një ide apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eco-inovative. Në rastin kur aplikimi i individeve është shpallur fitues, Bashkia Shkodër do të kërkojë regjistrimin e tij si një entitet ligjor përpara nënshkrimit të kontratës dhe disbursimit të fondeve.

**ii. Synimi i projektit**

Promovimi i zhvillimit të qendrueshëm ekonomik nëpërmjet eko-inovacionit.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Organizimi i një takimi të përbashkët me pjesmarrjen e institucioneve financiare, universitetin, organizata nderkombëtare, etj.
2. Realizimi i një memorandumi mirëkuptimi ndëmjet palëve pjesmarrëse.
3. Hartimi dhe miratimi i pakëtes së thirrjes për ide të gjelberta nga Këshilli Bashkiak Shkodër.
4. Shpallja e thirrjes dhe përzgjedhja e ideve fituesve.
5. Zbatimi dhe monitorimi i projekteve fituese.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale.
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane.
- Nxitja e ekonomisë rrethore dhe mundësive të reja të zhvillimi.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Financave dhe ekonomisë<br>Universiteti Luigj Gurakuqi | Bashkia Shkodër<br>Institucione financiare<br>Programet e BE-së<br>Organizatave ndërkombëtare. |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative | 2,300 | | | 300 | 2,000 | |
| | **Shuma** | **2,300** | | | **300** | **2,000** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative | 2,300 | | | 300 | 2,000 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shuma** | **2,300** | | | **300** | **2,000** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative | 2,300 | | | 300 | 2,000 | |
| | **Shuma** | **2,300** | | | **300** | **2,000** | |
| **f) f) ) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër | | | | |

| Nr.9 | **P04160.Q2.O1.A1**<br>Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Tregjet ekzistuese dhe ato të rejat që do ndërtohen e kane të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen.Sot ka tregje pa asnjë mbrojtje nga moti, pa tezga shitjeje, dhe akses të dobët si për blerësit ashtu edhe për shitësit. Edhe ambientet më të organizuara janë shumë të vogla për të mbuluar fluksin ekzistues të prodhimit. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukture e tezgave, banakeve,lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje në banjo publike, eletricitet, uje etj. Riparime në ambjentet e magazinimit te mallit etj.
Tarifat kundrejt përdorimit të hapsirave të tregtimit,duhet të përdoren edhe për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes.
I njejti model mirëmbajtje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit.

**ii. Synimi i projektit**

Një infrastrukture e përmirësuar e tregjeve do të ndihmonte veçanërisht në përmirësimin e kushteve tregtimit, rritjes së kënaqësisë së blerjes, përmirësim të higjenës dhe reduktimin e mbeturinave.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Evidentim i nevojës për mirëmbajtjen e tregjeve;
2. Shërbime të mirëmbajtjes dhe riparime të domosdoshme për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit:

**b) Rezultatet që prisni**

Tregje funksionale sipas standarteve dhe që plotësojne kushtet e tregtimit të lirë

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Fermerët | Bashkia shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | 0 | | | 0 | | |
| A.2 | Pagesat e sherbimeve me te trete (energji eletrike dhe uje. | | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | 0 | | | 0 | 0 | |
| A.2 | Pagesat e sherbimeve me te trete (energji eletrike dhe uje. | | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | **0** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | 0 | | | 0 | 0 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.2 | Pagesat e sherbimeve me te trete (energji eletrike dhe uje. | | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | **0** | |
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br>Drejtoria e shërbimeve Publike<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr.10 | **P04160.Q2.O1.A2.** Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br>**NN/Funksion 041:** Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>**Programi 04130**: Mbështetja për zhvillim ekonomik |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Velipoja është një ndër qëndrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar, gjithësesi mungojnë tregjet dhe nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Përgjatë sezonit të verës në këtë njësi administrative kemi praninë e shumë vizitorëve dhe turistëve të cilët përveq shërbimeve turistike kanë edhe nevoja për të konsumuar produkte të ndryshme të cilat duhet të tregtohen në ambientet e posaqme. Rrjeti i tregtisë në bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik lokale veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km.
Popullsia e përhershme në plazhin e Velipojës është rritur dukshëm duke arritur nga 387 në vitin 1990, në 2 075 banorë në 2016. Në vitin 2005 gjatë periudhës së verës, numri i pushuesve arrinte në 80 000, sipas statistikave gjate vitit  arrijnë mesatarisht deri në 100 000 pushues në fundjavat e pikut të sezonit. Duke marrë parasysh sasinë e lartë të produkteve të konsumuara si dhe nevojën për një mjedisi të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe. Duke qënë një zonë e cila ka edhe karakteristika bujqësore si dhe të shfrytëzimit të akuakulturës dhe peshkimit, impakti i ndërtimit të një tregu me hapsirat e përshtatshme të magazinimit e tregtimit, do të jetë shumë i lartë edhe në zhvillimin ekonomik. Krijimi i treguttëformalizuarakushërbimi dhe kontrollingaana e institucioneveështë me efektiv, eshtenje hap i nevojshemqëduhetndërmarrënëmënyrëqëtëkeminjëintegrim dhe standartizimtëekonomiverurale me sisteminekonomiktëbashkisëShkodër.
Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme.  Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve përfunksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim .Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimi me fermerët, furnizuesit, transportuesit, tregtaret, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.

**ii. Synimi i projektit**

Formalizimi i tregtimit te shitjes me pakicë në njësinë administrative Velipojë dhe sigurimi i kushteve te pershtatshme te tregtimit: Mbështetja prodhuesve vendas te bujqësisë, peshkimit dhe akuakulturës, rritja e tregtimit të produkteve si dhe siguria ushqimore.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Studim i fizibilitetit të investimit
2. Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik)
3. Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë
4. Rregullim i ambjenteve të tregjeve
5. Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike
6. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse.

**b) Rezultatet që prisni**

Ndërtim i një tregu të ri të shitjes me pakicë të produkteve lokale të njësisë administrative Velipojë

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e bujqësisë, Azhbr<br>Universiteti i Shkodër FSHZH | Bashkia Shkoder |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hartimi i projektit teknik | | | | | | |
| A.2 | Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit  të Investimeve<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër |

<table>
<tr><td>Nr.11</td><td>P04160.Q2.O1.A3<br>Ndërtimi i tregut multifunfsional të produkteve agro-ushqimore lokale</td><td colspan="5">Funksioni 4: Çështje ekonomike<br>NN/Funksion 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës<br>Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik</td></tr>
<tr><td colspan="7">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="7">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="7">Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore e blegtorale. Fermerët/tregtarët të cilët shesin produktet e tyre sezonale në kushte jo të favorshme duhen mbajtur parasysh për tu zgjidhur, pasi edhe kërkesat e tyre janë të shumta për përcaktim të një vendi stabël me kushte të përshtatshme tregtimi. Në territorin e Bashkisë Shkodër qytet janë evidentuar rreth 450 fermerë/tregtarë informal që kane nevojë për sistemim në një vend të përshtatshëm tregëtimi. Gjithashtu në Nj.A. e Bashkisë Shkodër ka kërkesë të vazhdueshme për ngritjen e një tregu për produktet vendase. Ndërtimi i Tregut Agroushqimor në qytet apo dhe në Nj.A., si një treg shumë-funksional dhe modern, i cili respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore gjithashtu rrit potencialin prodhues të sektorit bujqësor.<br>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar.<br>Në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkoder për zhvillimin ekonomik po bëhet planifikimi për ndërtimin e një tregu të shitjes me pakice për produkte lokale agroushqimore për të zhvilluar tregti të formave të standardizuara. Krijimi i tregjeve të formalizuara ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standardizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.</td></tr>
<tr><td colspan="7">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="7">Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Shkodër dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të tregtimit nëpërmjet ngritjes së tregut sipas standardeve.</td></tr>
<tr><td colspan="7">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="7">1. Analiza e prodhimit aktual dhe të ardhshëm të fruta-perimeve;<br>2. Analiza e fluksit të tregtimit të prodhimeve ekzistuese;<br>3. Analiza e infrastrukturës ekzistuese të tregjeve dhe evidentimi i nevojës<br>4. Hartimi i projektit teknik për ndertimin e tregut të shitjes me pakicë.<br>5. Ndërtimi i tregut në të shitjes me pakicë<br>6. Mbikqyrje<br>7. Kolaudimi</td></tr>
<tr><td colspan="7">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="7">1) Ndërtimi i tregut Agroushqimor për produktet vendase<br>2) Rritje e sigurisë ushqimore<br>3) Rritje e kënaqësinë së konsumatorëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="3">d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td colspan="4">Bashkia Shkodër</td><td colspan="3">Bashkia Shkodër</td></tr>
<tr><td colspan="7">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="4">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferi me</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Projektimi</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>A.2</td><td>Ndërtimi, mbikqyrja dhe kolaudimi i Tregut</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit 2024,2025,2026</td><td colspan="5">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</td></tr>
</table>

Note: the expense table also has a "Kapitale" column (all empty) after "Transferi me".

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. 12** | **P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për Web sitin e turizmit.** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Një ndër instrumentet më të fuqishëm dhe më aktual të promocionit është promovimi online. Krijimi i një faqeje të dedikuar për turizmin është i rëndësishëm pasi përveç se shërben si një platformë për të shpërndarë informacion rreth një destinacioni, duke lehtësuar planifikimin e udhëtimit për vizitorët, vepron dhe si një mjet i fuqishëm marketingu, duke promovuar veçoritë dhe atraksionet unike të Bashkisë Shkodër. Duke ofruar harta interaktive, rekomandime të personalizuara dhe përditësime në kohë reale, kjo faqe webi do të përmirësojë përvojën e përgjithshme të vizitorëve. Nëpërmjet veçorive si vlerësimet e përdoruesve dhe integrimi i mediave sociale nxitet angazhimin i përdoruesve. Udhëtarët mund të ndajnë përvojat e tyre, duke ofruar komente të vlefshme dhe duke ndikuar në vendimet e udhëtimit të të tjerëve.

Në kuadër të projektit Tourism4Albania po punohet për realizimin e websitit të turizmit. Sipas planit të aktiviteteve, websiti do të përfundojë brenda vitit 2023. Projekti ka filluar në maj të vitit 2022 dhe do të vazhdojë der në maj të 2025. Pas përfundimit faqja do të mirëmbahet nga bashkia. Përditësimi dhe mirëmbajtja e faqes është thelbësore për ruajtjen e saktësisë, rëndësisë, besimit të përdoruesve dhe konkurencës. Siguron që platforma të mbetet një burim i besueshëm dhe i vlefshëm si për vizitorët e mundshëm ashtu edhe për komunitetin lokal.

**ii. Synimi i projektit**

Synohet promovimi i destinacionit, përmirësimi i informacionit për vizitorët me qëllim zhvillimin ekonomik të bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Hostimi.
- Mirëmbajtja.
- Përditësim e shërbime shtesë.

**b) Rezultatet që prisni**

Ëebsite i mirëmbajtur dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Drejtoritë e ndryshme të Bashkisë (E Turizmit, e Kulturës, e Planifikimit të Territorit, Planifikimit Strategjik, e të Ardhurave etj.<br>• Universiteti i Shkodrës<br>• Bizneset | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• Shoqata e Artizanëve<br>• ATA |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit. | 0 | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit. | 0 | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit. | **150** | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2024-2026 | Stafi i drejtorisë së Turizmit.<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 13 | **P04130.Q3.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Zhvillimi i turizmit është gjithnjë e më shumë në fokusin e Bashkisë Shkodër dhe githashtu vërehet një interes gjithnjë e në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Përparimet teknologjike i kanë dhënë mundësinë të gjithëve për të pasur akses më të shpejtë e më të lire në informacionin për destinacione të caktuara. Krijimi i aplikacionit synon që të lehtësojë udhetimin e turistëve vendas dhe sidomos të huaj nëpër pikat e ndryshme turistike të Shkodrës në zbulim të trashëgimisë historike, natyrore e kulturore. Në të njëjtën kohë, ky aplikacion do të ndihmojë edhe bizneset e ndryshme që ofrojnë shërbime turistike për të zgjeruar aktivitetin e tyre, duke reklamuar në faqen e dedikuar të aplikacionit. Risia që do i ofrohet turistëve është vetë aplikacioni offline në ndihmë të klientëve, për të kursyer në tarifat e Internetit roaming apo për të zgjidhur pamundësinë e të pasurit Wi-Fi. Çdokush mund ta organizojë udhëtimin e tij nëpërmjet aplikacionit që do të jetë në celularin e tij në çdo moment, gjë që kursen jo vetëm shpenzime, por edhe kohë. Ky do të ishte një hov cilësor për tregun e turizmit në Shkodër, sepse është mundësia që ndryshimet të përditësohen nëkohë të shpejtë. Për të ofruar një cilësi sa më të lartë shërbimi të informacionit për turistët dhe për të përmirësuar sigurinë nevojitet që aplikacioni të mirëmbahet dhe azhornohet në vazhdimësi. Kjo do ndikonte mjaft në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër.

**ii. Synimi i projektit**

Synohet përmirësimi dhe lehtësimi i aksesit të informacionit për vizitorët.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Dizenjimi dhe krijimi i platformës
- Hostimi.
- Mirëmbajtja.
    - Përditësim e sherbime shtese.

**b) Rezultatet që prisni**

Një aplikacion dinamik për turizmin informacioni lehtësisht të arritshëm.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë.(Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj)<br>• Agjensia Kombëtare e Turizmit | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• ATA |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit. | **0** | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit. | **0** | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **0** | | | **0** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. 1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit. | **150** | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024-2026 | Stafi i drejtorisë së turizmit.<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 14 | **P04130.Q3.O1.A3.Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale.** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Turizmi është një sektor prioritar i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror edhe për ekonominë e bashkisë Shkodër. Ai gjeneron të ardhura më të larta për faktin që një sërë aktivitetesh ekonomike janë të lidhura me të, si dhe garanton punësim dhe mundësi vetëpunësimi. Me pasuri të veçanta natyrore, historike dhe me një pasuri të trashëgimisë kulturore, Shkodra ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik. Për të krijuar një identitet më të njohur për turizmin në Shkodër, për të përmirësuar konkurrencën dhe për të përmirësuar pozicionin në tregun turistik kombëtar, rajonal si dhe duke parë fluksin e turistëve dhe mbajtjen e tyre sa më gjatë në destinacionin tone, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe prodhuar materiale promociale (guidën turistike, harten turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, materiale të ndryshme promocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj). Për vitet në vazhdim, është menduar që fondi i parashikuar për realizimin e këtyre aktiviteteve të kryhet me blerje të përqendruar. Të gjitha materialet promocionale që do të realizohen do të jenë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë falas.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i informacionit turistik dhe diversifikim i ofertës turistike të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përmirësimi dhe rifreskimi i i informacionit në territorin e Bashkisë Shkodër.
- Prodhimi dhe botimi I materialeve promocionale
- Shpërndarja e materialeve.

**b) Rezultatet që prisni**

Rritja e numrit të turistive dhe kohëzgjatja e sezonit turistik në Bashkinë Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë, Drejtoria e turizmit | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **500** | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | 500 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **2,000** | | | 2,000 | | |
| | **Shuma** | **2,000** | | | **2,000** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **2,500** | | | 2,500 | | |
| | **Shuma** | **2,500** | | | **2,500** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2024-2026 | Stafi i Drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.15** | **P04130.Q3.O2.A1. Përmirësimi i aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve** | **Funksioni 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE**<br>**N/Funksioni: 047 Industri të tjera**<br>**Lloji i programit 04760: Zhvillimi i Turizmit** |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Territori i bashkisë Shkodër është ndër zonat më të pasura me burime natyrore, ku përfshihen edhe destinacionet më të frekuentura sa i takon turizmit natyror dhe atij malor. Këto zona turistike frekuentohen nga turistë kryesisht të huaj, të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe për interesimin ndaj mënyrës autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonave turistike ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët, të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar. Të gjitha facilitetet, përfshirë zonat rekreative dhe shtigjet për ecje, kanë nevojë për mirembajtje të rregullt për të zvogëluar dëmin e shkaktuar me kalimin e kohës dhe nga përdorimi. Mirëmbajtja e duhur është themelore për të garantuar sigurinë e vizitorëve, lehtësi në kalim, dhe për të inkurajuar përdorimin e itinerarit të caktuar.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit për vizitorët.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për pajisje me sinjalistikën dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Pregatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve.
- Kryerja e punimeve
- Botimi i një broshure informative.

**b) Rezultatet që prisni**

Markimi i shtigjeve dhe paisja me sinjalistikën përkatëse e shtigjeve.
Përmirësimi i standarteve dhe ofrmit të shërbimit përmes mirëmbajtjes së shtigjeve

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| – Stafi i Bashkisë<br>– Bizneset turistike<br>– Universiteti | – Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 600 | | | 600 | | |
| | **Shuma** | **600** | | | 600 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 600 | | | 600 | | |
| | **Shuma** | **600** | | | 600 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 600 | | | 600 | | |
| | **Shuma** | **600** | | | 600 | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Janar - Dhjetor 2024-2026 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.16 | P04130.Q3.O3.A1. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | Funksioni 4: Çështje Ekonomike<br>N/Funksioni 047: Industri të tjera<br>Programi 04760: Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Rrajoni jonë ofron një gamë të gjërë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneve turistike dhe atyre të produkteve bujqësore dhe gastronomike do të krijonte mundësinë për produktetë reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Të gjithë këto vlera të qytetit tonë duhtet të bëhen të njohura ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrja në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare është një alternativë mjaft e mirë për këtë qëllim.

**ii. Synimi i projektit**

- Promovimi i destinacionit përmes diversifikimit të ofertës turistike të territorit të Bashkisë Shkodër në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

**iii. Aktivitetetkryesore tëprojektit**

- Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në panaire.
- Prodhimi i materialeve promocionale per stendën e panairit.
- Pjesëmarrja në panaire.

**b) Rezultatet që prisni**

- Vizitorët që marrin pjesë në panair do të kenë një informacion më të plotë dhe të përditësuar për atraksionet dhe produktet turistike tëterritorit të Bashkisë Shkodër.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet emundshmenëprojekt |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë<br>• Bizneset turistike | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2024 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendë panairi, transport, qira hapësire, bileta udhëtimi,etj) | **800** | | | 800 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **800** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2025 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendë panairi, transport, qira hapësire, bileta udhëtimi,etj) | **800** | | | 800 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **800** | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2026 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner,fletëpalosje, stendëpanairi, transport, qira hapësire, bileta udhëtimi,etj) | **800** | | | 800 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **800** | | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit: |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024-2026 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.17 | **P04130.Q3.O3.A2. Iteneraret e shijes/promovimi i Slow food** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Shkodra njihet jo vetëm për natyrën e bukur, por edhe historinë, kulturën, rrugicat karakteristike si dhe artin e gatimit, që përcillet me aq finesë. Panairet e kulinarisë do të jenë një udhëtim përmes trashëgimisë së pasur gastronomike, kulturore, artistike, historike dhe bukurive natyrore të Shkodrës. Këto aktivitete syojnë t'i kthejnë Shkodrës vendin që i takon si një qytet ku turizmi zhvillohet mbi rrënjët e forta të traditës dhe pasurive të pafundme të territorrit, ndërthurur me elementet që koha i dikton. Aktivitetet e kulinarisë synojnë të promovojnë itenerarët e shijes dhe traditën e pasur gastronomike në territorin e bashkisë Shkodër dhe të rajonit.

**ii. Synimi i projektit**

- Rritja e numrit të turisteve në territorin e bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetetkryesore tëprojektit**

- Realizimi i panairit me bizneset lokale
- Organizimi i aktiviteteve si konkurse gatimi, degustime kulinarie, trajnime në fushën gastronomisë etj
- Program artistik
- Fushatë promovuese

**b) Rezultatet që prisni**

- Promovimi i gastronomisë dhe produkteve lokale

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë<br>• Bizneset turistike | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Realizimi i panairit (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,200** | | | | 1,200 | |
| | **Shuma** | **1,200** | | | | 1,200 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Realizim i panairit (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,500** | | | | 1,500 | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | | 1,500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Realizim i panair (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,500** | | | | 1,500 | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | | 1,500 | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024-2026 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.18 | P04130.Q3.O4.A1. Festa e Liqenit | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Liqeni i Shkodrës përbën një ekosistem të rëndësishëm vlerash natyrore që ndërthuren me vlera historike e kulturore. Si liqeni më i madh në Rajonin e Ballkanit dhe zonë e mbrojtur e kategorisë IV - Rezervat Natyror i Menaxhuar, e bën një zonë me shumë vlera ekologjike me fokus zhvillimin e qëndrueshëm.
Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministritë e Mjedisit respektive të Shqipërise dhe Malit te Zi. Aktivitete të larmishme, për diten e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës.

**ii. Synimi i projektit**

- Te promovoje dhe te mbeshtese zhvillimin e ekoturizmit ne Liqenin e Shkodres;

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Organizimi i një sërë aktivitetesh sportive ujore: gara noti;  kanoe; ëaterpool,
- Ekspozita Ëildlife dhe Panairi i bimeve mjekesore
- Panairi i artizanatit dhe kulinarise tradicionale
- Koncert kenge dhe valle me talentet te reja te qytetit

**b)Rezultatet që prisni**

- Promovimi i liqenit të Shkodrës si një burim ekonomik dhe turistik si edhe ndërgjegjësim i komunitetit për vlerat e tij mjedisore dhe të biodiversitetit.

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkoder<br>• Klubi Shumë sportësh “Vllaznia”<br>• Universiteti “LuigjGurakuqi” | • Bashkia Shkodër.<br>• OJF dhe TO |

e) Shpenzimet ellogaritura

| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërime, bluza, kapele, çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive,baner, postera, lajmërime, bluza, kapele,çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive,baner, postera, lajmërime, bluza, kapele,çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhendjekrealiziminеprojektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor  2024,2026 | Drejtoria eTurizmit<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.19 | **P04130.Q3.O4.A2. Valorizimi dhe mbrojtja e trashegimise se zonave malore** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Rigjallërimi i trashëgimisë dhe zhvillimi i turizmit te zonave malore duke mbështetur promovimin e diversitetit kulturor dhe natyror ne keto zona, mbetet nje nder prioritet kryesore te Bashkise Shkoder. Qëllimi kryesor është të ngreje vetëdijen dhe të kuptuarit e vlerës së trashëgimisë ekzistuese si dhe të sigurohet përjetimi i kënaqësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të trashëgimisë nga komunitetet lokale. Zona e Alpeve është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. Ajo ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit malor dhe të aventurës. Zhvillimi i ketij aktiviteti është konceptuar në mënyrë të tillë, që të përmbajë sa më shumë elementë të traditës lokale dhe të promovojë në mënyrë sa më gjithë përfshirëse atraksionet e vecanta të ketij destinacioni.

**ii. Synimi i projektit**

- Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të zonës së Alpeve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Panair të vlerave tradicionale të zonës, si veshje popullore, tradita e kulinarisë, artizanati,
- Ekspozite me foto të jetës së egër nga kjo zonë,
- Koncert me këngë e valle të zonës së Alpeve
- Aktivitetet në natyrë si birdëatching, ture botanike, vizita në sitet dhe vizita në monumentet historike te zones
- Realizimi i materialeve promovuese

**b)Rezultatet që prisni**

- Mbeshtetja e iniciativave për aktivitete edukative dhe rekreative me fokus zhvillimin e turizmit në një mjedis të mirëmbajtur natyror

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkodër<br>• Bizneset përfituese të turizmit.OJF<br>• Universiteti i Shkodrës, | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet ellogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | **900** | | | | 900 | |
| | **Shuma** | **900** | | | | **900** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | **1,000** | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | **1,000** | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudhaezbatimit**<br><br>Janar - Dhjetor 2024,2026 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria eTurizmit<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.20 | **P04130.Q3.O4.A3.** Dita e biçikletave | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Nëse ka një qytet që lidhet me historinë e biçikletave në Shqipëri, ky qytet është Shkodra. Qyteti me traditën më të hershme në Shqipëri në përdorimin e biçiletave, i kushton një ditë të veçantë festive këtij mjeti, që vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite nga rreth 30 përqind e banorëve, ç'ka e rendit atë në qytetin e pestë në Europë për nga përdorimi i biçikletave, gjithnjë në raport me numrin e banorëve. Me qellim promovimin e lëvizjes se qëndrueshme urbane të qytetit, ku prioriteti i jepet ecjes dhe pedalimit per te nxitur lëvizjen aktive dhe të shëndetshme, Bashkia Shkoder i ka kushtuar nje një vëmendje te vecante aplikimit të trendit të mobilitetit urban duke ndertuar korsite e bicikletave me nje shtrirje te gjere ne te gjithe qytetin duke u përfshirë në mënyrë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj kulture dhe tradite.

**ii. Synimi i projektit**

- Ripërtëritja e traditës dhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Aktivitete të ndryshme me fokus biçikleten
- Xhiro demostrative m ebicikleta
- Ekspozitë / konkurs fotografie
- Publikim i materialeve promocionale për përdorimin e biçikletës

**b) Rezultatet që prisni**

Realizimi i kësaj feste do të rrisën dërgjegjësimin qytetar për përdorimin e biçikletës dhe do të krijojë një atmosferë festivenë qytet.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • BashkiaShkoder<br>• DAR<br>• Klubi Shumësportësh Vllaznia | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime të çertifikatave, bluzave, baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj, ndriçim,etj) | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime të çertifikatave, bluzave,baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj, ndriçim,etj) | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. (Printime të çertifikatave, bluzave, baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj, ndriçim,etj) | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024,2026 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.21 | P04130.Q3.O4.A4. "Lojra Popullore Fest" | Funksioni 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE<br>N/Funksioni: 047 Industri të tjera<br>Lloji i programit 04760: Zhvillimi i Turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

"Lojra Popullore Fest" është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrëse. "Lojra popullore fest" gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike e kombëtare e ndërkombëtareVetë të rinjtë konkurojnë me performanca me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe enografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës.

**ii. Synimi i projektit**

- Të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve.
- Të promovojë dhe t'i njohë ata me traditat e njesive administrative të Bashkisë Shkodër, te rajonit dhe me tej, me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore.
- Të përfshijë të gjithë njësite administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe rajonin, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përzgjedhja e trupave kandidate për pjesëmarrje
- Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura
- Përgatitja e ambjentit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë.
-

**b) Rezultatet që prisni**

Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njësive administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe angazhimi i të rinjve përmes një pjesmarrjeje të gjerë

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| – Stafi i Bashkisë Shkodër (Drejtoria e Turizmit)<br>– Komuniteti<br>– Institucione publike | – Bashkia Shkodër.<br>– Qendra Kulturore e femijeve<br>– ZVA Shkoder |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktivitetit. | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br><br>Janar - Dhjetor 2024-2026 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr. 22 | P04130.Q3.O5.A1. Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të turizmit nënkupton reduktimin e varfërisë dhe gjenerimin e mundësive të reja për punësim dhe të ardhura në nivel lokal dhe rajonal. Turizmi sot është një nga sektorët prioritarë dhe me një impakt të madh në zhvillimin ekonomik të bashkisë Shkodër. Rritja e profesionalizmit të të punësuarve në industrinë e turizmit, si dhe ngritja e kapaciteteve menaxhuese do të hapin rrugën për përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve turistike, si dhe do ta mirëpozicionojn Shkodrën në ofertën rajonale dhe ndërkombëtare.Të gjithë aktorët në industrinë e turizmit duhet të punojnë së bashku dhe të koordinojnë aktivitetet, në mënyrë që të eliminojnë pengesat që qëndrojnë mes tyre dhe të arrijnë qëllimet strategjike. Nisur nga sa më lart, për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të turizmit nëpërmjet vizionit që udhëheq punën e Bashkisë Shkodër për hartimin e projekteve-pilot, duke garantuar jetësimin e tyre dhe transformimin në modele zhvillimi me mundësi replikimi, parashikohet krijimi i platformave të bashkëpunimit për të garantuar realizimin e iniciativave të përbashkëta nëpërmjet partneritetit privat–publik, bashkëpunimit të ngushtë me donatorët dhe grupet e interesit, botën akademike dhe shoqërinë civile.

**ii. Synimi i projektit**

Mbështetja e iniciativave të reja për krijimin injë imazhi cilësor dhe të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet përdorimit të sigurt dhe të kontrolluar të burimeve dhe potencialeve lokale, duke garantuar shërbime, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Zbatimini i iniciativave të përbashkëta ( projekteve) të partneritetit publik-privat në bashkëpunim të ngushtë me donatorë dhe grupe të interesit në fushën e turizmit.

**b) Rezultatet që prisni**

Projekt-ide inovative që ndihmojnnë në rritjen dhe avancimin e zhvillimit të turizmit

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| • Bashkia Shkodër<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• OJF Universiteti i Shkodrës,<br>• Fakulteti Ekonomik/Dega Turizëm | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2024 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit** | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit** | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Mbeshtetja e iniciativave te reja ne mbeshtetje te zhvillimit te turizmit** | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | 500 | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024- 2026 | Stafi i drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 23 | **P04130.Q4.O1.A1.** Rrjeti I zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Në situatën aktuale të zhvillimit të turizmit ku territori i Bashkisë Shkodër, vizitohet nga një numër i madh vizitorësh të huaj, një pjesë e të cilëve vijnë në mënyrë të vetëorganizuar dhe pa e njohur territorin. Në këtë kuadër informacioni turistik merr një rëndësi të veçantë, pasi i shërben orientimit të këtyre vizitorëve duke i njohur ata me atraksionet e territorit të Shkodrës, oraret e funskionimit, mjetet e trasnportit publik etj. Bashkia Shkodër disponon dy zyra të informacionit turistik, njërën në qytetin e Shkodrës dhe tjetra në plazhin e Velipojës. Ato janë konstruksione pjesërisht druri dhe pjesërisht mur dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes së tyre përbëhet nga vetrata e xhamit. Si konstruksione të tilla, ata kanë një normë të lartë amortizimi si edhe vetratat e mëdha prej xhami nuk sigurojnë izolim termik në objekt duke e bërë mjaft të vështirë qëndrimin dhe shërbimin në këto zyra. Prandaj, kemi gjykuar që të bëhen punime riparuese që do të sigurojnë kushte më të mira pune për personelin dhe rrjedhimisht edhe përmirësim të performancës së zyrës.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i shërbimit në zyrat e informacionit turistik në Shkodër dhe Velipojë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Identifikimi i nevojave për ndërhyrje dhe hartim i dokumentacionit tekniko ligjor.
2. Zhvillimi i prokurimit publik.
3. Kryerja e punimeve dhe marrja në dorëzim e objektit.

**b) Rezultatet që prisni**

Zyra bashkëkohore të informacionit turistik në Shkodër dhe Velipojë.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset e shërbimeve turistike<br>• Firmat e ndërtimit | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Rikonstruksion I Zyrave te informacionit** | 300 | | | | | 300 |
| | **Shuma** | **300** | | | | | **300** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Rikonstruksion I Zyrave te informacionit** | 500 | | | | | 500 |
| | **Shuma** | **500** | | | | | **500** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Rikonstruksion I Zyrave te informacionit** | **500** | | | | | **500** |
| | **Shuma** | **500** | | | | | **500** |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024- 2026 | Stafi i drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 24 | **P04130.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të drejtorisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësive të turizmit** | **Funksioni 4:** Çështje Ekonomike<br>**N/Funksioni 047:** Industri të tjera<br>**Programi 04760:** Zhvillimi i turizmit |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Paga dhe shtesat mbi paga

Zbatimi i Buxhetit për shpenzime personeli, bazohet tek numri I punonjësve dhe nivelin e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagën dhe ne përputhje me aktet nën ligjore në fuqi brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Përgrupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar,të nëpunësve civilë e tëpunonjësve
administrativë të njësive të vetëqeverisjesvendore” dhe ne zbatim te udhezimit nr. 1 date 04.04.2023 per pergatitjen e PBA 2024-2026 dhe Buxhetit te Bashkise Shkoder per vitin 2024, urdherit nr. 593 date 19.05.2023 “ Per llogaritjen e pagave faza I e PBA 2024-2026, shkreses 1808/b date 23.05.2023” struktura e administrates per perllogaritjen e pagave 2024-2026

**ii. Synimi i projektit**

Qeverisje e mire lokale, nëpërmjet përdorimit eficient dhe profesional të burimeve njerëzore

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Sigurimi i shpenzimeve për paga,sigurime shoqërore dhe shëndetësore për administratën vendore.

**b) Rezultatet që prisni**

Shpërblimin ne mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administrates vendore në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Drejtoria e Burimeve njerezore-Bashkia Shkoder<br>Drejtoria e finances -BashkiaShkoder | • Bashkia Shkodër. |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Paga dhe sigurime per stafin e turizmit** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |
| | **Shuma** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2025** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Paga dhe sigurime per stafin e turizmit** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |
| | **Shuma** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2026** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Paga dhe sigurime per stafin e turizmit** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |
| | **Shuma** | 17,021 | 14,865 | 2,336 | | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2024- 2026 | **Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |